

Banka e Shqipërisë



Rezultatet e Vrojtimit të Biznesit dhe të Konsumatorit

Maj 2009


Publikimi i ardhshëm i rezultateve të vrojtimeve të besimit do të bëhet në 14 gusht 2009

Tendenca ekonomike

Treguesi i tendencës ekonomike (TTE) ra me 33 pikë përqindjeje në tremujorin e parë të vitit 2009 duke shënuar vlerën 67.5. Vlera aktuale e treguesit të tendencës ekonomike qëndron nën mesataren e tij historike. Rënia aktuale e TTE është më e theksuar se rënia në tremujorin e katërt të vitit të kaluar gjatë të cilit treguesi ra me 15 pikë përqindje, por duke mbetur gjithsesi afër vlerave të mesatares historike.

Rënia e treguesit të tendencës në tremujorin e parë reflekton keqësimin e pothuajse të gjithë treguesit përbërës të tij, me përjashtim të treguesve të besimit të konsumatorit të cilët paraqiten në nivele të njëjta me tremujorin e mëparshëm. Bizneset kanë vlerësuar se aktiviteti në sektorin e shërbimeve dhe ai në sektorin e ndërtimit kanë pësuar rënien më të theksuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2009.

Grafik 1: Treguesi i Tendencës Ekonomike.




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë

Sektori i industrisë

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) tregon për rënie të aktivitetit prodhues në tremujorin e parë të vitit 2009. Treguesi i besimit, pasi pësoi një rënie të lehtë në tremujorin e kaluar, ra me 14.3 pikë përqindje në tremujorin aktual. Rënia në treguesin e industrisë është ndikuar nga rënia në të tre balancat përbërëse: vlerësimi i bizneseve për prodhimin aktual, për punësimin në industri dhe për gjendjen e inventarëve. Nga të tre treguesit, vlerësimi për ecurinë e prodhimit ka pësuar rënien më të thellë.

Grafik 2: Treguesi i Besimit të Industrisë.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBI:

Vlerësimi i bizneseve për *ecurinë e ekonomisë* në përgjithësi gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 pësoi rënien më të theksuar, balanca e të cilës ka rënë me rreth 40 pikë përqindjeje. Pesimist paraqitet edhe vlerësimi për *aktivitetin e përgjithshëm të biznesit* gjatë tremujorit të parë (balanca ra me rreth 21 pikë përqindjeje). Çmimet e prodhimit, të cilat qëndruan të pandryshuara në tremujorin e katërt të vitit 2008, kanë regjistruar një rënie të lehtë gjatë tremujorit aktual.

Kërkesa e brendshme në tremujorin e parë është vlerësuar në rënie, së bashku me kërkesën për *eksporte*. Më shumë se gjysma e bizneseve të industrisë (55 për qind) janë shprehur se *kontratat porositëse* në tremujorin e parë janë më të ulëta se normalja. Rreth 74 për qind e bizneseve janë shprehur se nuk kanë kryer investime në gjashtëmujorin e fundit.


Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese të bizneseve të industrisë ka rënë me 10 pikë përqindje në tremujorin e parë, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2008, duke shënuar vlerën 61.8 për qind. Shfrytëzimi i kapaciteteve ka rezultuar më i lartë në nënsektorin e industrisë të mallrave të konsumit dhe të industrisë përpunuese, përkatësisht 62.4 për qind dhe 62.5 për qind dhe më i ulët për industrinë e mallrave kapitalë, përkatësisht 56.4 për qind.

Pritjet për tregues të ndryshëm të aktivitetit të industrisë për tremujorin e dytë të vitit 2009 dhe për kryerjen e investimeve në gjashtëmujorin e ardhshëm mbeten negative.

Sektori i ndërtimit

Aktiviteti në sektorin e ndërtimit, bazuar në opinionet e bizneseve është vlerësuar në rënie në tremujorin e parë të vitit 2009. Treguesi që përmbledh aktivitetin në këtë sektor, treguesi i besimit në ndërtim (TBN), ra me 17.5 pikë përqindjeje. Në tremujorin e katërt të vitit 2008 TBN u rrit me 2 pikë përqindjeje. Vlera aktuale e TBN qëndron nën mesataren historike të tij. Rënia në këtë tregues u diktua nga vlerësimet negative të bizneseve ndërtuese për kërkesën, prodhimin dhe punësimin në këtë sektor.

Grafik 3: Treguesi i Besimit të Ndërtimit.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBN:

Vlerësimi i bizneseve për *ecurinë e ekonomisë* në përgjithësi dhe për *ecurinë e aktivitetit ndërtues* gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 është negativ dhe në rënie nga vrojtimi i kaluar. Vlerësimi për *ecurinë e biznesit* ishte përmirësuar ndjeshëm në tremujorin e katërt të vitit 2008. Aktualisht 56 për qind e bizneseve ndërtuese i vlerësojnë të pamjaftueshme kontratat porositëse të regjistruara në tremujorin e parë.

Gjendja e inventarëve, pas një rritjeje në tremujorin e katërt të vitit 2008 është vlerësuar në ulje në tremujorin e parë të këtij viti. Në të njëjtën kohë, *çmimet e prodhimit* të firmave ndërtuese pas rënies në tremujorin e katërt të vitit të kaluar, regjistruan rritje në tremujorin e parë të vitit 2009.


Bazuar në vrojtimin e fundit, 75 për qind e bizneseve ndërtuese nuk kanë kryer *investime* në pajisje teknologjike të reja gjatë gjashtëmujorit të fundit.

Pritjet për tremujorin e dytë paraqesin një panoramë të ngjashme me situatën aktuale, ku pjesa më e madhe e treguesve të aktivitetit pritet të keqësohen.

Sektori i shërbimeve

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2009, treguesi i besimit të shërbimeve (TBSH) ra me 15.8 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Kjo rënie u shkaktua nga vlerësimi negativ për tre treguesit përbërës të tij: ecuria e përgjithshme *ekonomike*, situata e *punësimit* si dhe situata *financiare*. Vlera aktuale e TBSH qëndron nën mesataren e tij afatgjatë.

Grafik 4: Treguesi i Besimit të Shërbimeve.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBSH:

Kërkesa në sektorin e shërbimeve ka vijuar prirjen rënëse që nga tremujori i mëparshëm. Në të njëjtën kohë, në rënie vlerësohet edhe gjendja e përgjithshme e biznesit, ku balanca neto ra me rreth 19 pikë përqindjeje krahasuar me T4-08. Problemet lidhur me rendin dhe sigurinë, situata politike si dhe korrupsioni dhe ekonomia joformale renditen ndër faktorët të cilët kanë penguar zhvillimin normal të aktivitetit të tyre.


Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në T1-09 ka rënë në rreth 67.2 për qind nga 73.6 për qind që ishte në tremujorin e mëparshëm.

Pritjet e firmave të sektorit të shërbimit për tremujorin e ardhshëm janë më pesimiste se vlerësimet e shprehura për tremujorin e parë 2009. Pritjet për gjendjen ekonomike dhe ecurinë e përgjithshme të biznesit gjatë T2-09 janë negative. Gjithashtu, në nivele negative qëndrojnë edhe pritjet për kërkesën dhe situatën e punësimit.

Besimi i Konsumatorëve

Treguesi i Besimit të Konsumatorit (TBK), në T1-09, shënoi një përmirësim të lehtë duke u rritur me rreth 0.1 pikë përqindjeje krahasuar me T4-08. Përmirësimi i lehtë në këtë tregues u përcaktua nga përmirësimi i balancës mbi situatën e blerjeve në shuma të mëdha si dhe pritjet mbi situatën financiare për tremujorin e ardhshëm. Ndërsa, pritjet e konsumatorëve për situatën e përgjithshme ekonomike dhe gjendja aktuale financiare kanë ndikuar negativisht në IBK. Treguesi i Besimit të Konsumatorit, ashtu si në tremujorin paraardhës, edhe në këtë tremujor qëndron nën mesataren e tij afatgjatë.

Grafik 5: Treguesi i Besimit të Konsumatorit.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBK:

Situata *ekonomike* dhe *financiare* është vlerësuar negativisht dhe në rënie nga konsumatorët gjatë T1-09. Vlera negative vazhdon të shënojë edhe balanca e *kostos mesatare të jetesës*.

Pritjet e konsumatorëve për *inflacionin pas 12 muajsh* në tremujorin e parë të vitit qëndrojnë rreth vlerës 2.02 për qind.

Pritjet e konsumatorëve për çmimet pas një tremujori dhe pas një viti vazhdojnë prirjen rënëse që nga vrojtimi i kaluar. Për sa i përket nivelit të papunësisë në gjashtëmujorin e ardhshëm, rreth 46 për qind e konsumatorëve presin që ai të rritet dhe rreth 18 për qind e tyre presin që ai të ulet.

Tabelë 1: Treguesit e besimit sipas sektorëve*.

	vlerat që nga T2-2002			2008				2009	Situata	
	min.	mes.	max.	T1	T2	T3	T4	T1	Konjunkturale**	Strukturore***
Industri	-9.7	-0.2	9.1	2.8	1.6	0.9	-3.7	-18.0	↓	--
Ndërtim	-14.0	-1.1	10.1	9.1	7.6	-0.3	1.4	-16.1	↓	--
Shërbime	-16.5	1.7	19.6	7.1	7.6	18.9	10.3	-5.5	↓	-
Konsumator	-20.5	-12.9	-7.8	-13.6	-11.7	-10.5	-17.4	-17.3	↑	--

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Me përjashtim të treguesit të konsumatorit, treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara sezonalisht.

**) Situata krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

***) Situata për secilin tregues konsiderohet shumë e kënaqshme (+ +) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e kënaqshme (+) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e pakënaqshme (-) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe situata konsiderohet shumë e pakënaqshme (-) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2: Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë*.

	2007		2008				2009	Pritje
	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2-09
Kërkesa								
Total	3.9	6.8	5.5	4.3	8.3	5.1	-11.5	-16.6
Industri	0.9	10.3	3.0	-0.1	-0.8	-5.3	-30.7	-22.4
Ndërtim	-5.2	10.3	6.2	11.4	1.8	5.6	-22.9	-9.9
Shërbime	9.1	4.1	5.9	2.3	14.1	8.1	-0.3	-18.0
Situata ekonomike e firmës								
Total	-2.5	8.8	8.4	7.5	8.7	6.2	-12.4	-13.9
Industri	-8.6	15.1	-1.4	-0.3	-5.0	-5.6	-28.0	-22.2
Ndërtim	-10.4	7.2	5.4	9.2	-12.6	-0.9	-15.5	-5.3
Shërbime	3.1	7.8	12.8	9.1	23.0	13.2	-6.2	-15.4
Punësimi								
Total	-3.2	4.2	4.7	3.2	10.3	4.8	-3.8	-9.6
Industri	-9.7	7.0	4.2	0.7	3.0	-8.0	-21.7	-17.9
Ndërtim	-12.2	7.5	4.6	4.5	-2.5	-4.1	-12.8	-13.6
Shërbime	3.0	1.8	5.0	3.3	18.6	12.9	5.8	-5.1
Prodhimi								
Total	-9.0	8.0	12.2	3.8	-2.1	-0.5	-18.4	-11.1
Industri	-9.7	9.2	5.4	-0.9	-5.2	-5.6	-27.3	-18.8
Ndërtim	-8.6	7.3	16.5	6.9	-0.1	2.8	12.6	-6.1
Konsumatorët								
Situata financiare	-6.6	-9.6	-13.5	-9.7	-3.8	-9.9	-15.0	-0.5
Kostoja e jetesës	-9.0	-8.1	-4.6	-6.6	-21.1	-12.4	20.4	-13.3
Çmimet pas 1 viti	34.8	27.9	25.2	21.1	23.0	17.3	9.5	
Blerje të mëdha	-49.2	-45.7	-50.9	-45.8	-43.7	-52.7	-50.5	-38.6
Kursim	-50.0	-52.8	-53.2	-50.3	-50.6	-54.4	-52.2	-46.6

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Me përjashtim të sektorit të konsumatorëve, balancat janë të rregulluara sezonalisht.